



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK**

Nr. 858 / Prot. 16

Vlorë më, 19.03.2025

VENDIM

Nr. 30, datë 19.03.2025

PËR

**MIRATIMIN E PLANIT MWSIMOR SË PROGRAMIT TË STUDIMIT "WEB DHE
DIZENJIM DIGITAL"**

Në mbështetje të nenit 38, pika 1, shkronja d, të Ligjit nr. 80/ 2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 19, pika 1, gërma dh, të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, Udhëzimit nr.1, datë 14.01.2020 "*Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen , rioorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen dhe bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë*" si dhe referuar shkresës së Sektorit të Kurrikulave dhe Statistikave me nr. 951 datë 19.03.2025, Senati Akademik në mbledhjen e tij të datës 19.03.2024,

VENDOSI:

3. Të miratojë planin mësimor të programit profesional 2(dy vjeçar) "Web dhe Dizajn Digital" sipas materialit bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore, si dhe Zëvendësrektori Akademik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE

PROGRAM STUDIMI PROFESIONAL 2-VJEÇAR "PROGRAMIM WEB DHE DIZENJIM DIGJITAL"

Miratuar në Mbledhjen e Senatit të Universitetit "Ismael Qemali",
.....

Ky plan mësimor do të zbatohet gjatë vitit akademik 2025-2026

DREJTUESE E DEPARTAMENTIT


Dr. Alketa HYSO

DEKANI

Prof. Asoc. Miftar RAMOSAÇAJ

REKTORI

Prof. Dr. Aurela SALIAJ



**KUADRI I PËRGJITHSHËM FORMUES I PROGRAMIT TË STUDIMIT PROFESIONAL 2-VJEÇAR
"PROGRAMIM WEB DHE DIZENJIM DIGJITAL"**

Program studimi profesional "Programimi Web dhe Dizënjimi Digjital"										
Ndarja e Lëndëve	Nr	Kodi	Lënda	Kredite	Sipas Tipit të Veprimtarive					
LËNDË TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM - A (18 kredite) (10-15%)	1	MKT 097	Strategji të digjitale dhe menaxhimi i mediave sociale.	6						
	2	CS 098	Dizajni dhe kultura në shekullin XX-XXI	6						
	3	CS 101	Bazat e programimit	6						
	4	CS 102	Dizënjim digjital	6						
	5	CS 103	Zhvillim Web I	6						
	6	CS 104	Zhvillim Web II	8						
	7	CS 106	Dizënjim grafik	6						
	8	CS 107	Projektim dhe administrim i bazave të të dhënave	6						
	9	CS 209	Hyrje në përvojën e përdoruesit	6						
	10	CS 200	Zhvillim backend me PHP dhe MySQL	6						
	11	CS 202	Zhvillim aplikacionesh mobile	6						
	12	CS 203	Fotografi dixhitale dhe manipulim imazhesh	6						
	13	CS 206	Dizënjimi i ndërfaqeve të përdoruesit	7						
	LËNDË INTEGRUESE /ZGJEDHJE - C (18 kredite) (5-15%)	14	CS 108	Siguri kibernetike	4					
		15	CS 204/CS 201	Animacion dhe vizualizim të dhënash/ Zhvillimi i lojrave bazuar në teknologji të Web	8					
		16	CS 207/CS 208	Inovacionet teknologjike / Hyrje në cloud computing	6					
		17	ENG 131T/ ENG 132T/ FRE 131T/ GER 131T/ ITA 131T	Gjuhë e huaj	6					
18		CS 297	Praktikum	4						
19		CS 298	Praktikë aktive në institucion	5						
20		CS 299	Punim diplomë /Provim formimi	6						
LËNDË PLOTËSUESE gjuhë të huaj, aftësi në informatikë, apo praktika – 15 kredite (10-15%) - D										
DETYRIME PËRMBYLLËSE – 6 kredite (3-5%) - E										

[illegible]



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE DHE NATYRORE
DEPARTAMENTI I SHKENCAVE KOMPUTERIKE

PROGRAMI I STUDIMIT PROFESIONAL 2-VJECAR

"PROGRAMIM WEB DHE DIZENJIM DIGJITAL"

PËRSHKRIMI I LËNDEVE

Semestri I

CS 101 - Bazat e Programimit (6 ECTS).

Kjo lëndë ofron një hyrje në programim duke përdorur gjuhë si Python ose C. Studentët mësojnë strukturat e të dhënave (arrays, lists, dictionaries), algoritmet bazë (loop, conditionals, functions) dhe konceptet e programimit procedural dhe modular. Fokus kryesor është zhvillimi i aftësive logjike dhe zgjidhja e problemeve përmes kodimit. Projekti përfundimtar përfshin krijimin e një programi funksional me input/output dhe manipulim të të dhënave.

CS 098 - Dizajni dhe Kultura në Shekullin XX-XXI (6 ECTS).

Lënda eksploron evolucionin e dizajnit grafik, industrial dhe dixhital nga Bauhaus deri te dizajni modern. Studentët analizojnë lëvizjet artistike, rolin e teknologjisë në komunikimin vizual dhe ndikimin e dizajnit në përvojën e përdoruesit. Përmes studimeve të rasteve dhe projekteve krijuese, ata zhvillojnë aftësi për të aplikuar konceptet estetike në dizajn.

ENG 131T/ENG 132T/GER 131T/TA 131T/FRE 131T. Gjuhë e Huaj (6 ECTS).

Lënda zhvillon aftësitë gjuhësore në të folur, të shkruar dhe të lexuar në një gjuhë të huaj (anglisht, frëngjisht, gjermanisht ose italisht). Fokus kryesor është terminologjia teknike dhe përdorimi i gjuhës në kontekst profesional. Studentët angazhohen në dialogje, prezantime dhe përkthime të teksteve teknike.

CS 102 - Dizajnim Digital (6 ECTS).

Studentët mësojnë konceptet bazë të dizajnit si teoria e ngjyrave, tipografia, hierarkia vizuale dhe rregullat e kompozimit. Përdorin softuerë si Adobe Photoshop dhe Illustrator për krijimin e grafikave, ikonave dhe materialeve vizuale për ueb dhe media sociale. Projekti final përfshin krijimin e një identiteti vizual për një markë të re.

CS 103 - Zhvillim Web I (6 ECTS).

Lënda fokusohet në HTML5, CSS3 dhe JavaScript për krijimin e faqeve web responsive dhe interaktive. Studentët mësojnë teknika si flexbox, grid, media queries dhe efektet e animuara me CSS dhe JavaScript. Përmes projekteve praktike, ata ndërtojnë një faqe web të optimizuar për pajisje mobile dhe desktop.

Semestri II

CS 104 - Zhvillimi Web II (8 ECTS).

Kjo lëndë përqendrohet në përdorimin e framework-eve si React ose Vue për ndërtimin e aplikacioneve dinamike. Studentët mësojnë përdorimin e API-ve, manipulimin e DOM-it, menaxhimin e gjendjes me Redux dhe autentifikimin me JSON Web Tokens. Projekti final është ndërtimi i një aplikacioni web interaktiv me backend të lidhur.

MKT 097 - Strategjitë Digjitale dhe Menaxhimi i Mediave Sociale (6 ECTS)

Kjo lëndë fokusohet në zhvillimin e strategjive të marketingut digjital dhe menaxhimin efektiv të mediave sociale për biznes dhe markë. Studentët mësojnë për SEO (Search Engine Optimization), SEM (Search Engine Marketing), reklamën në platformat si Facebook, Instagram dhe Google Ads, si dhe analitikën e performancës së fushatave. Gjithashtu, trajtohen teknikat e krijimit të përmbajtjes (content marketing), angazhimi i audiencës dhe strategjitë e influencer marketing. Përmes analizave të rasteve studimore dhe projekteve praktike, studentët do të krijojnë dhe implementojnë një fushatë digjitale të plotë, duke përdorur mjete si Google Analytics, Meta Business Suite dhe platforma të tjera të menaxhimit të përmbajtjes.

CS 106 - Dizënjim Grafik (6 ECTS).

Lënda përqendrohet në krijimin e materialeve vizuale për print dhe dixhital, duke përdorur Adobe Illustrator dhe Photoshop. Studentët mësojnë për kompozimin vizual, manipulimin e imazheve dhe krijimin e materialeve reklamuese. Projekti final konsiston në krijimin e një fushate vizuale për një produkt ose shërbim.

CS 107 - Projektim dhe Administrim i Bazave të të Dhënave (6 ECTS).

Studentët mësojnë krijimin e bazave të të dhënave relacionale me SQL, duke përdorur MySQL dhe PostgreSQL. Konceptet përfshijnë modelimin e të dhënave, normalizimin, pyetjet e avancuara dhe integritimin e bazës së të dhënave me aplikacione web. Projekti final përfshin krijimin e një sistemi menaxhimi të të dhënave për një biznes ose institucion.

CS 108 - Siguri Kibernetike (4 ECTS).

Lënda mbulon konceptet bazë të sigurisë së informacionit, enkriptimit, mbrojtjes së rrjetëve dhe identifikimit të sulmeve kibernetike. Studentët analizojnë sulmet më të zakonshme si phishing, SQL injection dhe malware. Përmes laboratorëve praktikë, ata zbatojnë teknika për mbrojtjen e të dhënave dhe vlerësimin e rrezikëve.

Semestri III

CS 200 - Zhvillimi Backend me PHP dhe MySQL (6 ECTS).

Kjo lëndë u mëson studentëve bazat e programimit backend duke përdorur PHP dhe MySQL për të ndërtuar dhe menaxhuar faqe dhe aplikacione dinamike. Studentët do të mësojnë si të krijojnë sisteme për menaxhimin e të dhënave, të zhvillojnë API për komunikim me front-end dhe të sigurojnë aplikacionet e tyre. Përmes kombinimit të leksioneve, seminareve dhe laboratorëve praktikë, studentët do të fitojnë aftësi për të zhvilluar aplikacione funksionale me bazë të dhënash dhe për të optimizuar kodin për performancë dhe siguri më të lartë.

CS 201 - Zhvillimi i Lojërave Bazuar në Teknologjitë Web (8 ECTS) (Zgjedhje)

Kjo lëndë u mësion studentëve si të krijojnë lojëra interaktive duke përdorur HTML, CSS dhe JavaScript. Ata do të punojnë me biblioteka dhe engine si Phaser.js për të ndërtuar lojëra 2D që funksionojnë në shfletues. Gjatë kursit, do të mësojnë konceptet bazë të lojërave, si lëvizja e personazheve, ndërthdihja me përdoruesin dhe krijimi i efekteve vizuale dhe tingulje. Në fund, studentët do të zhvillojnë një lojë të plotë që mund të luhet online.

CS 202 - Zhvillim Aplikacionesh Mobile (6 ECTS)

Kjo lëndë u mësion studentëve si të krijojnë aplikacione për telefonat dhe tabletet që përdorin Android dhe iOS. Ata do të punojnë me mjete dhe gjuhë si Flutter, React Native ose Kotlin për të ndërtuar aplikacione interaktive dhe funksionale. Gjatë kursit, studentët do të mësojnë si të krijojnë dizajne të bukura, të ruajnë dhe të përdorin të dhëna, si dhe të testojnë dhe përmirësojnë aplikacionet e tyre. Në fund, ata do të krijojnë një aplikacion të plotë që mund të përdoret në pajisjet mobile.

CS 203 - Fotografi Dixhitale dhe Manipulum Imazhesh (6 ECTS)

Kjo lëndë u mësion studentëve bazat e fotografisë dixhitale dhe teknikat e përpunimit të imazheve. Ata do të mësojnë si të përdorin një kamerë, të rregullojnë ndriçimin, kompozimin dhe këndet për të krijuar foto cilësore. Gjithashtu, do të punojnë me programe si Adobe Photoshop dhe Lightroom për të retushuar, modifikuar dhe krijuar efekte artistike në imazhe. Në fund të kursit, studentët do të realizojnë projekte krijuese duke kombinuar fotografi dhe dizajn dixhital.

CS 204 - Animation dhe Vizualizim të Dhënash (8 ECTS). (Zgjedhje)

Lënda mbulon krijimin e animacioneve dhe grafikëve interaktivë duke përdorur Adobe After Effects, CSS animations dhe D3.js. Studentët mësojnë teknika të vizualizimit të të dhënave për storytelling dhe infografikë. Projekti final konsiston në zhvillimin e një animacioni të bazuar në të dhëna reale.

CS 297 - Praktikum (4 ECTS)

Kjo lëndë ofron mundësinë për studentët të aplikojnë njohuritë e marra në kursin e mëparshme në projekte praktike. Ata do të punojnë në zhvillimin e faqeve web, dizajnimin e materialeve grafike dhe krijimin e aplikacioneve të thjeshta për klientë ose projekte të tjera reale. Studentët do të fitojnë aftësi për të punuar në ekip, menaxhuar projekte dhe përmirësuar aftësitë praktike në zhvillimin web dhe dizajn dixhital. Projekti përfundimtar do të përfshijë zhvillimin dhe prezantimin e një produkti dixhital.

Semestri IV

CS 206 - Dizajnimi i Ndërfaqeve të Përdoruesit (7 ECTS).

Studentët eksplorojnë principet e dizajnit UI, ndërtimin e wireframe-ve dhe prototipizimin me Figma dhe Adobe XD. Fokus kryesor është krijimi i ndërfaqeve intuitive për aplikacione mobile dhe web. Projekti final përfshin krijimin e një dizajni të personalizuar për një aplikacion real ose konceptual.

CS 207 - Inovacionet Teknologjike (6 ECTS) (Zgjedhje)

Kjo lëndë u prezanton studentëve teknologjitë më të reja dhe zhvillimet inovative në fushën e IT-së. Ata do të mësojnë për inteligjencën artificiale, internetin e gjërave (IoT), realitetin virtual dhe të shtuar (VR/AR) dhe ndikimin e tyre në industri të ndryshme. Gjithashtu, do të analizojnë tendencat teknologjike dhe si këto mund të përdoren për të krijuar zgjidhje kreative dhe efikase. Në fund të kursit, studentët do të zhvillojnë një projekt që përfshin një nga këto teknologji.

CS 208 - Hyrje në Cloud Computing (6 ECTS) (Zgjedhje)

Kjo lëndë u mësion studentëve bazat e cloud computing dhe shërbymeve që ofron, si rrastja e të dhënave dhe fuqia kompjuterike në distancë. Ata do të mësojnë si të përdorin platforma si Google Cloud, AWS dhe Microsoft Azure për të ndërtuar dhe menaxhuar aplikacione në cloud. Gjithashtu, do të trajtojnë sigurinë dhe përfitimet e përdorimit të cloud-it në zhvillimin e fageve web dhe aplikacioneve. Në fund të kursit, studentët do të krijojnë një projekt praktik duke përdorur një nga këto shërbyme. Studentët eksplorojnë ndikimin e këtyre teknologjive në industrinë e dizajnit dhe zhvillimit web.

CS 209 - Hyrje në Përvojën e Përdoruesit (6 ECTS).

Lënda mbulon konceptet UX/UI, heuristikat e përdorshmërisë dhe metodat kërkimore si testimi i përdoruesve dhe analiza e sjelljes. Studentët mësojnë wireframing, prototipizim dhe optimizimin e përvojës në platforma të ndryshme. Përfundimisht, ata zhvillojnë një studim të detajuar të një produkti dixhital dhe japin rekomandime për përmirësimin e tij.

CS 298 - Praktike Aktive në Institucion (5 ECTS).

Studentët aplikojnë njohuritë e tyre në një institucion ose kompani përmes një praktike profesionale. Ata punojnë në projekte reale që përfshijnë zhvillim web, dizajn grafik ose strategji dixhitale. Në fund, prezantojnë një raport mbi përvojën dhe aftësitë e fituara.

CS 299 - Punim Diplome / Provim Formimi (6 ECTS).

Studentët realizojnë një projekt përfundimtar që përmbledh aftësitë e fituara gjatë studimeve. Ata zhvillojnë një aplikacion të plotë, një platformë dixhitale ose një fushatë vizuale. Mbrojtja e projektit përfshin një prezantim dhe raport analitik mbi procesin e zhvillimit.